

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KONTRAKTOR
DREJTORIA RAJONALE OSSH sh.a Kukes

Adresa : Rr. "Islam Spahiu", Prapa Ish Kinemase, Kati II, Kukës

Nr. _____ Prot.

Kukes, më __ / __ /2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rikonstrukcion i pjesshem rrjeti TU me kabell ABC i Fiderave 8, Mamez, Shemri, Kukes.”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Puna e ndërtimit për linjat e energjisë elektrike **31321000-2**

VLERA E FONDIT LIMIT: 74,270,200 (shtatedhjetë e katër milion e dyqind e shtatedhjetë mijë e dyqind) leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria Rajonale Ossh sha Kukes** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimimit, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues sipas përcaktimeve të nenit 26, VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar.

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare. (2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 100% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a dhe nenin 47 “Procedura e hapur” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Në rastin konkret nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Ky kriter siguron që operatorët ekonomikë që marrin pjesë kanë kapacitetin financiar për të përmbushur detyrimet e kontratës në mënyrë të sigurtë dhe të efektshme. Ky është i rëndësishëm për të shmangur situata ku operatorët nuk plotësojnë kapacitetin financiar dhe nuk mund të përfundojnë projektin.

2.2.2 Kopje të certifikuara të bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse (Administrata Tatimore) të dy viteve të fundit (2023, 2024 dhe 2025). Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 i ndryshuar (Ligji nr. 126/2024) atëherë bilanci duhet të shoqërohet edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat"*, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të ***Ligjin nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar*** “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 10091/2009 i ndryshuar (***Ligji nr.126/2024***): “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh**; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh**; iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2025 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar (**të vitit 2026**) sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR-se.

Per piken 2.2.3 është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, duhet të dorezoj dokumentacionin provues për çfarë kerkohet më sipër i cili duhet të jetë orgjinal ose kopje e noterizuar.

Argumentimi: Ne lidhje me kerkesen per pagesen e taksave vendore referojme se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Njësia e prokurimit kerkoi edhe pagesat e taksave vendore bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1.Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerese se fondit limit, që është realizuar gjatë pese viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.
Ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlere monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pese viteve të fundit, është jo më e vogël se 150% e fondit limit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Ne rast se punimet Jane kryer me ente publike:

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vertetime të lëshuara nga një ent publik, për permbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë për të vertetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime për permbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar
 - Aktin e kolaudimit
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim / Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
 - Fatura Tatimore të deklaruara në organet tatimore

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve, shoqëruar me:
 - Kontrate Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar
 - Fatura tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat jo më të vogla se 40% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose 150% e vlerës së fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Kriteri i kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Përmirësimi i infrastrukturës së linjave TM/TU kërkon një kohë të konsiderueshme për të kryer punët me sukses dhe në përputhje me standardet e nevojshme. Përdorimi i operatorëve me përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje.

Përvoja e mëparshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët janë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situatat e mundshme në mënyrën e duhur.

Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedure.

2.2.3 *Licënsa profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:*

2.3.2 (Kapacitetet teknike dhe profesionale)

a) **Licënsa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të Kontratave**

- | | | |
|---|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria NP-1 • Kategoria NP-11 | <p>Punime germimi në toke,</p> <p>Ndertime për n/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)</p> | <p>Klasifikimi A</p> <p>Klasifikimi C</p> |
|---|--|---|

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Shenim: Në rast pjesëmarrjeje të një Operatori ekonomik të huaj, ky i fundit, Licencën e mesipërme me kategoritë e përshkruara, duhet ta ketë të njohur pranë organeve përkatëse në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit të saj në fuqi.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehesimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008).

** Në rast të bashkimit të operatoreve ekonomike, Licencat profesionale duhet të paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përse punimet për të cilat kërkohet Licënsa Profesionale.*

b) Çertifikatat që duhet të paraqesin operatori ekonomik:

Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001: 2015 për Sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente (të vlefshme)
- ISO 14001:2026 për Sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit ose ekuivalente (të vlefshme)
- ISO 45001: 2023 për Sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë ose ekuivalente (të vlefshme)

ISO-t e mesipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë ISO duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë, sipas natyrës së punëve që marrin përsipër.

Shënim: Për certifikatat e mesipërme Operatorët Ekonomikë ofertues mund të paraqesin dokument ekuivalent që standartizon këto certifikata sipas standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto certifikata janë unifikuar nga kjo Drejtori.

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM nr. 943, datë 28.12.2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" dhe Rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim".

Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(të ndryshuar), dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në licencën profesionale për zbatimin e punimeve,

kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë propocionale me objektin e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P-1	Punime germimi e toke)	Germim gropa shtyllash, toke e forte kat IV, ~2.5m, sip tab 1.5m	A	0-20 milion leke
N.P-11	(Ndertime per N/stacionet, kab transformatoreve, linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise	Demontim percjelles, demontim paneli, montim paneli, F.V kabell Abc, Zgjidhja e telit TU ne qafat e izolatoreve per nje etj	C	51-100 milion leke

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të Ligjit 162/2020 të Prokurimit Publik, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Konkretisht:

- Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 9001:2015 ose ekuivalent, na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE I interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mire të cilësisë.
- Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 45001:2018 ose ekuivalent, është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta e për këtë arsye, AK duhet të sigurohet se OE zotëron kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës. Paisja me këtë lloj certifikimi dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.
- Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 14001:2015 ose ekuivalent , pasi zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kësaj kontrate. Të gjitha punimet e parashikuara në këtë procedurë duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

c) Operatori ekonomik duhet të ketë punësuar të paktën 26 persona e vertetuar kjo me:

1. List pagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione te akredituara nga autoritetet pergjegjese shteterore, dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:

- 17 (shtatembdhjete) punonjës elektrikist te pajisur me kartela personale te sigurimit teknik, te leshurara nga organe kompetente te akredituara sipas Ligjit Nr. 8734, date 01.02.2001 “Per garantimin e sigurise se punes te pajisjeve dhe te instalimeve elektrike”, i ndryshuar.
3 (tre) prej tyre te jene te pajisur Grupin e IV ose me larte te sigurimit teknik.

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar ose me kontrate bashkepunimi 4 (kater) manovrator te makinerive te renda te pajisur me deshmite e drejtimit te leshuar nga institucioni perkatese si dhe te pajisur me kartela personale te sigurimit teknik. Ne rast se OE i ka te punesuar manovratoret duhet te paraqese kontratë pune të vlefshme si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë.

- Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë *te pakten 2(dy) shofere*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme, *Deshmi Aftesie Profesionale te vlefshme (leshuar nga institucionet perkatese).*

(Në rastin kur punonjësit /shofere janë të kontraktuar me kontratë pune/sherbimi (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

- Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë *te pakten 6 (gjashte) punetore krahu të kontraktuar me kontratë pune/sherbimi (nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë)*

Argumentimi: Kërkesa është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

- a. Per kerkesen per specialiste elektriciste, njesia e prokurimit eshte bazuar ne punimet elektrike qe do behen sipas zerave perkates te preventivit.

Argumentim i detajuar per numrin e punonjesve.

1. Staf per Punime elektrike.

Bazuar ne zerat e preventivit dhe sipas oreve te punes nxjerre nga manuali i e-albania per punimet elektrike rezulton se ne total punime elektike ne te cilat nevojitet nderhyrja dhe puna e personelit te specializuar elektriçiste, rezulton se per periudhen 9 mujore ne te cilen ky objekt duhet te perfundoje, jane ne total 27 026 ore pune elektike / 1512 (ore pune per 9 Muaj) per te cilat nevojiten minimum 17 elektriçiste nga te cilet 3 duhet te jene me grupin IV ST te sigurimit ose me lart.

2. Staf per Punime dhe germime me krahe.

Bazuar ne zerat e preventivit dhe sipas oreve te punes nxjerre nga manuali i e-albanias per punime germimi apo te ndryshme me krahe, rezulton se ne total punime per te cilat nevojitet puna e nje personelit te pa specializuar (punetore krahu), rezulton se per periudhen 9 mujore ne te cilen ky objekt duhet te perfundoje jane ne total 9916 ore pune punime + germime me krahe/ 1512 (oret e punes per 9 Muaj) , per te cilet duhen minimum 6 punetore te pa specializuar.

3. Staf per Transport me Mjete transporti.

Kerkohet ne preventiv dhe ne manualin e-albania eshte me kodin 4.167 (*Transport materiale elektrike me kamion me vinc 5 - 10 ton deri 20 km*) dhe bazuar ne oret dhe volume e punes per periudhen 9 mujore nevojiten minimum 2 shofer.

4. Staf per Germime & Shtrime te ndryshme me makineri Eskavator.

Kerkohet ne preventiv dhe ne manualin e-albania eshte me kodin 3.498/b , 3.88/a etj..dhe bazuar ne oret dhe volume e punes per periudhen 9 mujore nevojitet minimum 2 manovrator.

5. Staf per punime me vinç kulle 0.5 – 1 ton.

Kerkohet ne preventiv dhe ne manualin e-albania (*punime me vinç kulle per punime dhe ngritje dhe montim ne lartesi materialesh*) dhe bazuar ne oret dhe volume e punes per periudhen 9 mujore nevojiten minimum 2 manovratore.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, duhet të dorezoj dokumentacionin provues për cfarë kerkohet më sipër i cili duhet të jetë orgjinal ose kopje e noterizuar.

d) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar te pakten 1 (nje) Ing. Ndertimi dhe 1 (nje) Ing. Elektrik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, duhet të dorezoj dokumentacionin provues për cfarë kerkohet më sipër i cili duhet të jetë orgjinal ose kopje e noterizuar.

dh) Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe te deklaroje se ai do te jete i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryen punimet ne objek, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtem:

a) Kontratë pune e vlefshme

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, duhet të dorezoj dokumentacionin provues për cfarë kerkohet më sipër i cili duhet të jetë orgjinal ose kopje e noterizuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kriteri i punësimit të një inxhinieri elektrik dhe një inxhinieri ndertimi si drejtues teknik me licencë është i rëndësishëm për disa arsye. Me qëllim ndërtimin e objektit të veprës sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qënë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është mbi 30,000,000 milion në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, të përfshirë në liçensimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Drejtuesi teknik duhet të disponojë kualifikimet e kërkuara, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*.

Vendosja e një inxhinieri elektrik dhe një inxhinieri ndertimi si drejtues teknik siguron që puna do të kryhet në përputhje me standardet teknike dhe me kujdesin e duhur për sigurinë e punonjësve dhe të mjedisit. Ky kriter ndihmon në garantimin e cilësisë së punëve. Inxhinieri elektrik si drejtues teknik është përgjegjës për monitorimin e punimeve dhe menaxhimin e situatave teknike që mund të dalin gjatë zbatimit. Kërkesa për të siguruar që inxhinieri elektrik është i regjistruar dhe i siguruar në listat e pagesave të sigurimeve për një periudhë të caktuar siguron se operatori ekonomik respekton të gjitha detyrimet legjislative dhe siguron që punonjësit janë të mbrojtur në rast të ndonjë aksidenti ose dëmtimi. Eshtë kërkuar të kete në staf Inxhinier Ndërtimi, i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e preventivit të punimeve për anën ndërtimore kryesisht për ndërtimin e bazamentit të kabines box, ndërtimin e bazamentit të shtyllave të betonit, për punime civile, rikthimin në gjendjen e mëparshme të rrugës dhe përcaktimin e shtresave përberese të saj etj.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e duhur për të dëshmuar që ka përmbushur këtë kriter. Ky dokumentacion përfshin kontratën individuale të punës, diplomën e inxhinierave, CV, librezë pune dhe liste pagesa.

e) Operatori ekonomik duhet të kete një person të caktuar të pajisur me certifikate si *“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”* në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* i ndryshuar dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”* i ndryshuar.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Certifikata e cituar më sipër, kontratë pune e vlefshme.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, duhet të dorëzoj dokumentacionin provues për çfarë kerkohet më sipër i cili duhet të jetë orgjinal ose kopje e noterizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, **si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”**

Në nenin 39 *“Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”* pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”* i ndryshuar parashikohet: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe /ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;*

Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, autoriteti kontraktor ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit si dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit duke përfshirë ketu numrin total të punonjësve (inxhinieri, teknike, specialiste, punonjes të kualifikuar dhe punetore për punime me krahe, drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të renda etj).

Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standardeve të përcaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 *“Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”* Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të të regjistruara në *“rregjistrat profesionale”* të AKAFP-se. Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punes si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të janë bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”*. Bazuar në këto elementet e struktura të kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

2.3.1 (Makineri Pajisje)

Operatori ekonomik duhet të paraqesë automjetet dhe makinerit (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Pershkrimi i Automjetit	Sasia
1	Autovinc 8 ton ose me shume	1 copë
2	Ekskavator	1 cope
3	Autovinc 16 ton ose me shume	1 copë
4	Kambaleca per mbajtjen e barabaneve te kablllove	2 cope
5	Vinc kulle 0.5 ton ose me shume	2
6	Trailer 40 ton ose me shume	1 cope
7	Betoniere 500 l ose me shume	1 cope
8	Vibrator	1 cope
9	Terraometer per matjen e rezistences se tokezimit	1 cope

- 1- Per mjetet qe shenohen ne rregjistra publike duhet te paraqitet dokument qe verteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi) plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe per mjetet e siguruar me qira, dokumentat qe verteton rregjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit te vlefshme duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerase / furnizimit e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt e ketij prokurimi.
- 2- Per paisjet ne pronesi shoqerohen me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.
- 3- Per makinerite me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates shoqeruar me dokumentin qe verteton rregjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit, certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin, (te vlefshme).
- 4- Per paisjet me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per kete objekt shoqeruar me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.
- 5- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar sipas shtojcës 8 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.
- 6- Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

- 7-Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe të pranojë verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimimit, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues për çfarë kërkohej më sipër i cili duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

1. Eskavator.

Kërkohej në preventiv dhe në manualin e-albania është me kodin 3.498/b etj dhe bazuar në orët dhe vëllime të punës për periudhën 9 muaj nevojitet minimum 1 mjet Eskavator.

2. Mjete transporti vetshkarkuese auto vinç .

Kërkohej në preventiv dhe në manualin e-albania dhe bazuar në orët dhe vëllime të punës për periudhën 9 muaj nevojiten minimum 1 Autovinc 8 ton ose më shumë, 1 Autovinc 16 ton ose më shumë.

3. Vinç kulle 0.5 – 1 ton.

Kërkohej në preventiv dhe në manualin e-albania (*punime me vinç kulle për punime dhe ngritje dhe montim në lartësi materiale*) dhe bazuar në orët dhe vëllime të punës për periudhën 9 muaj nevojiten minimum 2 mjete të tipit Vinç kulle 0.5 – 1 ton.

4. Betoniere kantieri.

Kërkohej në preventiv dhe në manualin e-albania është me kodin 3.243 (*Shtresë betoni C 16/20*) dhe bazuar në orët dhe vëllime të punës për periudhën 9 muaj nevojitet minimum 1 betoniere kantieri.

Argumentimi i perlllogaritjes se vleres se fondit limit.

1. Preventivat jane hartuar sipas VKM Nr. 216 date 13.04.2023, botuar ne fletoren zyrtare Nr.66 date 19.04.2023.
2. Paga orare eshte marre nga E-Albania, sipas VKM Nr. 216 date 13.04.2023 629.për zerat jashte liste.
3. Çmimet e bazes materiale jane marre nga E-Albania si dhe ne baze te manualit te SAP - it, ne OSHEE,.
4. Per punimet e montimit qe nuk jane ne manual i referohemi udhezimit Nr. 2 date 08.05.2003 "Per klasifikimin dhe strukturen e koston se punimeve te ndertimit.
5. Norma e fitimit eshte marre 10 % sipas VKM Nr. 216 date 13.04.2023, botuar ne fletoren zyrtare Nr.66 date 19.04.2023
6. Analizat teknike qe nuk jane ne VKM Nr. 216 date 13.04.2023, jane hartuar si zera jashte liste bazuar ne librin Nr. 6 " Montimi i liniave dhe nënstacioneve " si dhe librin e " Normave komunale".
7. Ne kete preventiv nuk jane llogaritur vlerat per mbikqyrje, kolaudim dhe leje ndertimi.
8. Dherat e germuar largohen plotesisht.
9. Te gjitha proceset e zbatimit te punimeve duhet te kryhen nen mbikqyrjen dhe miratimin e mbikqyresit te punimeve.
10. Te gjitha materialet qe do te përdoren duhet te aprovohen nga mbikqyresi i punimeve para montimit te tyre ne objekt.

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor apo nënligjor, në bazë të të cilit është bërë përlllogaritja teknike e numrit të punonjësve dhe mjetet/makineritë/pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës)

2.3.4 Afati i kryerjes se punimeve eshte 9 (nente) muaj nga data e dorezimit te sheshit.

Operatori ekonomik duhet te paraqesi grafikun e punimeve ne perputhje me afatin kohor qe eshte lene ne dispozicion per realizimin e kontrates. Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet: ”Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit parashikon me grafik, fazat dhe afatet e realizimit të punimeve” Njësia e Prokurimit pasi u konsultua gjerësisht me Degën Teknike për afatin që duhej përcaktuar për kryerjen e punimeve, vendosi që afati i punimeve të ishte 9 **(nente) muaj**, si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Autoreteti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.2 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1.
.....

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

Argumentimi i specifikimeve teknike

- *Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i specialisteve të Drejtorisë Qendrore OSHEE sh.a/ OSSH sh.a duke krijuar një unifikim për të gjithë shoqëritë OSHEE sh.a/ OSSH sh.a, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor mbi objektin procedurës së prokurimit, duke përlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.*

1. Në shtojcat përkatëse të specifikimeve teknike ngarkuar në SPE, AK ka kërkuar: “*Certifikatat e fabrikës ISO 9001*”.

Kjo certificate kërkohej në momentin e levrimit të mallit nga operatori ekonomik fitues dhe shoqëron mallin që instalohet në objekt. Kurse në momentin e ofertimit, AK pranon mundësinë të një vetëdeklarimi nga OE ofertues që në këtë rast, furnizuesi është konform standardeve të cilësisë dhe rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit

2. Në Shtojcën specifikimet teknike ku AK ka kërkuar të paraqesin “*Te gjithë test raportet e fabrikës*”.

Në rastet kur është kërkuar “Te gjithë test raportet e fabrikës” sipas specifikimeve teknike, këto teste janë përcaktuar në materialin “Specifikimet teknike” në paragrafet “Standartet referuese” dhe “TESTET

3. Në specifikimet teknike, AK i është referuar standardeve europiane: “**IEC 60439-1, IEC 60 947-2, IEC 898, IEC 947-1, ...etj**”, por **do të pranojë dhe ekuivalentet e tyre sipas legjislacionit në fuqi.**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”

Njesia e Prokurimit